



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:190281
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728854

Ac.nr.5908/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, kundër të paditurit F. K. nga fshati Sh., Komuna Podujevë, me objekt të padisë kompensim dëmi, në vlerë prej 1,114.00€, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.243/2019, datë 25.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e të paditurit F. K. nga fshati Sh., Komuna Podujevë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.243/2019, datë 25.06.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.243/2019, datë 25.06.2021, gjykata e shkallës së parë jashtë seance ka vendosur: I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri F. K. nga fshati Sh., Komuna Podujevë, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit- borxhi të shkaktuar të dëmtuarës në aksidentin e dt.25.09.2016 të ndodhur në Podujevë, ën shumën prej 1,114.00 € me kumatën të cilën e paguajnë bankat afariste të R. Kosovës, për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive. II. Shumën e aprovuar i

padituri detyrohet t'ia paguajë paditëses në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. III. Refuzohet si e pabazuar kërkesa e palës paditëse që kamata të llogaritet nga dita e ushtrimit të padisë në gjykatë deri në pagesën definitive si dhe kërkesa për shpenzime të procedurës kontestimore në shumën prej 30.00 eurove. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo që i njëjti të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se paditësja të ketë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e të paditurit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datën 06.05.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurit F. K., për shkak të rimbursimit të dëmit. Në padi ka pretenduar se i padituri ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin e tij i cili ka qenë pa mbulesë siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit ashtu që paditësja me anë të ujdisë e ka kompensuar të dëmtuarin dhe në procedurë jashtëgjyqësore iu ka drejtuar të paditurit që të njëjtës t'ia ribmursojë dëmin e dhënë të dëmtuarit mirëpo e njëjta nuk është realizuar, ashtu që përmes padisë ka kërkuar që i padituri t'ia ribmursojë dëmin në vlerë prej 1,114.00 €, me kamatë si për mjetet e deponuara në bankat afaristë pa destinim të caktuar duke llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas pranimit të përgjigjes në padi të ushtruar nga i padituri ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar (*pa shqyrtim kryesor të çështjes*) C.nr.243/2019, i datës 25.06.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim” lidhur me nenet 143 dhe

147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor. Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadiës, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara. Andaj, gjykata, konform nenit 152 të LPK-së, gjeti së kërkesëpadija e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përkatësisht nenit 245, par.1 ku është përcaktuar se: “Kreditori në marrëdhëniet detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kurse debitori është i obliguar ta përmbushë atë me ndërgjegje në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij.” Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 277 të LMD-së (të vitit 1978). Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet taksave gjyqësore në shumë prej 20 eurove.

Gjykata e Apelit nuk e përkrah vlerësimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe ligjshëm pasi që vlerëson se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 lidhur me nenin 152 të LPK-së, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për çka detyrimisht aktgjykimi është dashur të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës së paditur gjeti se të njëjtat janë të themelta, ashtu që kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi është marrë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 lidhur me nenin 152 të LPK-së sepse fillimisht nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara me dispozita ligjore që të nxjerrët aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes. Neni 152 i LPK-së përcakton se: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Në vështrim të dispozitës së lartëcituar, rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për tu nxjerrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi që kjo dispozitë i lejon gjykatës të merret ky lloj aktgjykimi kur i padituri i pohon faktet vendimtare përkundër kontestimit të padiës. Duke analizuar këto kushte dhe pas shikimit të shkresave të lëndës, Gjykata e Apelit nuk mundi që të gjejë se janë plotësuar kushtet të nxirret aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, pasi që nga shkresat e lëndës më saktësisht nga përgjigja në padi, i padituri nuk i ka pohuar faktet vendimtare ngase nuk e ka pohuar faktin crucial se paditëses i ka borxh shumë të kërkuar në padi prej 1,114,00 euro dhe se si rrjedhojë e kësaj nuk konsiderohet se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare. Në rastin konkret, i padituri e konteston padinë dhe faktet e treguara në padi duke theksuar se nuk ka kurrfarë borxhi ndaj paditëses ngase shkaktimit të këtij aksidenti sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit në

rastin konkret i kanë kontribuar ngasësi i automjetit “A” të vet të paditurit si edhe ngasësi i automjetit “B”- B. J.. Nga shikimi i padisë dhe provave të dorëzuar nga ana e paditëses, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate nuk mund të arrihet në përfundim se del themelësia e kërkesëpadisë së paditëses nga faktet e treguara në padi.

Andaj, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë kundërshtimet e palës së paditur, ashtu që gabimisht ka marrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes dhe e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses pa i vlerësuar të gjitha faktet vendimtare që qojnë në një përfundim të tillë. Po ashtu pala e paditur në përgjigje në padi, e ka kontestuar përpos bazës ligjore edhe fajësinë e tij duke pretenduar se paditësja nuk ka ofruar prova të mjaftueshme, mirëpo përkundër këtyre kundërshtimeve gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes duke aplikuar gabimisht dispozitat ligjore, për çka kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi si i tillë nuk mund të qëndrojë dhe detyrimisht duhet anuluar.

Meqenëse, Gjykata e Apelit gjeti se ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të sipër theksuara, e njëjta nuk u lëshua në pretendimet të tjera për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë konform vërejtjeve të dhëna nga gjykata ankimore ashtu që fillimisht të eliminojë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, ashtu që të caktojë seancën e shqyrtimit kryesor duke siguruar praninë e palëve ndërgjyqëse në procedurë, të vlerësojë thëniet e palës paditëse dhe asaj të paditur, të vërtetojë përgjegjësinë eventuale të palës së paditur dhe të vërtetojë drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, pas administrimit të provave të propozuara nga të dyja palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të arsyetuar detajisht të provave që i shqyrton dhe i administron. Pas përfundimit të këtyre veprimeve të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm, e gjithmonë duke iu përmbajtur dispozitës së nenit 160 të LPK-së lidhur me përpilimin e aktgjykimit.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 195.1 pika (c) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.5908/2021, datë 23.05.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli